



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	04.11/20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 Nr. 060/01-26878/20				

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së IX-të (Nëntë) e Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 30 Tetor 2020.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e IX-të (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 30 Tetor 2020, dhe atë:

1. Vendim për Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-22499/20 i datës 12.08.2020 - Për kompensimin e Komisioneve të Kuvendit të Komunës Kaçanik / Lënda: 01Nr. 060/01-27581/20;
2. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A. - Njësia në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 060/01-26898/20.

Vendimin ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tij nga Zyra Ligjore e autoritetin mbikëqyrës.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 060/01-27581/20
Kaçanik, 30.10.2020

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016) si dhe në bazë të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar sipas Shkresave të MF dhe MAPL 020-599/3 të datës 28.08.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Tetor 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01NR. 060/01-18351/20 –PËR KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, **ANULOHET** Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-22499/20 i datës 12.08.2020 - Për kompensimin e Komisioneve të Kuvendit të Komunës Kaçanik.
2. Anulimi i Vendimit i përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet sipas Kërkesë të MAPL 020-599/3 të datës 28.08.2020- respektivisht Shkresës së konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjës- Ministria e Financave, së i njëjti është në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe me Ndryshim Plotësimin e këtij ligji.
3. Para marrjes së këtij Vendimi, Kryesuesi i Kuvendit me datë 11.09.2020 iu ka Përgjigjur MF dhe MAPL me Shkresë 01Nr. 60/01-22499/20, mirëpo nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga këto dy organe, kështu që Kuvendi i Komunës Kaçanik vendosi si në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 060/01-18351/20
Kaçanik, 12.08.2020

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 17 dhe 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) të nenit 49 pika 2 lidhur me nenin 34.5 dhe 61 të Statutit të Komunës 01Nr. 60/01-12895/20 (teksti i spastruar i Statutit) të nenit 15 (g) të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 060/01-18351/20 prej datës 07.08.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 12 Gusht 2020, mori këtë:

V E N D I M
PËR KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, bëhet kompensimi i të gjitha komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës Kaçanik, në shumë, **50 € (pesëdhjetë euro)**, për pjesëmarrje në mbledhje.
 - 1.1. Kompensimi i përcaktuar nuk duhet të tejkaloj mbi gjashtë (6) mbledhje për një vit.
2. Kompensimi nga pika 1 e këtij vendimi në formë retroaktive do t'iu bëhet edhe të gjitha komisioneve të kësaj legjislature (Legjislatura 6 e KK) që kanë kryer aktivitetin e tyre për çështjet që janë formuar e që nuk janë kompensuar deri me tani, qoftë komisionet që janë me mandat të caktuar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës dhe atyre Ad Hoc (për çështje të caktuara).
3. Kompensimi nga pika 1 dhe 2 e këtij Vendimi, do t'iu bëhet vetëm anëtarëve të komisioneve që janë përfaqësues nga Kuvendi i Komunës dhe anëtarëve të jashtëm të komisioneve (përfaqësues të OJQ /shoqëria civile).
4. Kompensimi për anëtarët e komisioneve të përcaktuara në këtë vendim, do të fillojnë menjëherë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E KAÇANIKUT
 OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

Kuvendi i Komunës

-Kryesuesi i Kuvendit-

Data	11.08.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	60/01-22499
		Shtojcë	

PËR :

1. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, znj. Rozafa Ukimeraj-; dhe
2. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financa, z. Enis Spahiu.

Kopja: Zv. Drejtoreshës së Departamentit Ligjor në MF, znj. Bahrije Berisha.

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Lidhja e Juaj- Konfirmimi i Ligjshmërisë së Aktit të Komunës 020-599/3 e datës 26.08.2020 lidhur me Vendimin e KK 01Nr. 060/01-18351/20 -Për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës Kaçanik, i datës 12 Gusht 2020.

Të nderuar sekretarë të përgjithshëm të ministrive; znj. Rozafë Ukimeraj dhe z. Enis Spahiu, përshëndetje,

Lidhur me Vendimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik, 01Nr. 060/01-18351/20- për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës Kaçanik i miratuar me datë 12.08.2020, shqyrtimi i ligjshmërisë nga Ministria e Financave- Departamenti ligjor i kësaj ministrie në krye me Zv. drejtoreshën, Bahrie Berisha, 020-599/2 i datës 26 Gusht 2020, dërguar me Shkresën e MAPL, 020-599/3 e datës 28.08.2020 (numrat në shkresa nuk janë shumë të dukshme), ka vlerësuar së Vendimi nuk është i ligjshëm. Departamenti ligjor i MF është thirrur në nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, që ndalon kompensimet shtesë për punonjës, shërbyes civil, ose i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të qeverisë që kërkohet të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës nuk duhet të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Ne vlerësojmë së;

1. Është krejt në rregull ky nen i ligjit të potencuar për shërbyesit civil dhe zyrtarëve tjerë publik të cilët kanë pagë mujore, ndërkaq Vendimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik 01Nr. 060/01-18351/20- Për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës është për kompensimin e anëtarëve të komisioneve që janë anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve nga OJQ, ndërkaq kompensimi i shërbyesve civil as që është përmendur në këtë vendim, kur dihet fakti së çështja e kompensimeve shtesë të shërbyesve civil është e rregulluar me një rregullorë të nivelit qendror.

2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk kanë orar të përcaktuar, ndërkaq sipas Udhëzimit Administrativ 16/2008- Për pagesën e stafit politik në komuna, marrin kompensim në formë paushalli 100 € në muaj Bruto dhe 125€ kompensim për pjesëmarrje në mbledhje në maksimum për 12 mbledhje në vit apo minimumin e mbledhjeve obliguese, 10

mbledhje për një vit me kompensim sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008) + 2 Komitetet obliguese që paguhën për pjesëmarrje në mbledhje nga 50€ në të cilat komitete përfshihen disa anëtarë të KK. Nisur nga ky kompensim, që i bien 225€ Bruto për një anëtar të KK apo 275 € Bruto për anëtarët e KK që janë edhe anëtarë të komiteteve, i bien me pak sesa Paga minimale në Republikën e Kosovës, ndërkaq për funksionimin e Kuvendit të Komunës janë të nevojshme formimi i komisioneve duke përfshirë në komisione edhe anëtarë nga Kuvendi i Komunës.

3. Po të hynte në fuqi Ligji për Pagat në Republikën e Kosovës, anëtarët e KK kanë pasur të përcaktuar Pagën mujore diku mbi 400 € + 100€ kompensim për pjesëmarrje në mbledhje të KK, ndërkaq çdo angazhim tjetër shtesë i anëtarëve të KK nëpër komisione, kishte me qenë i panevojshëm dhe i paarsyeshëm.

4. Arsyeja e marrjes së këtij Vendimi ka qenë nevojë dhe domosdoshmëri, për shkak të kompensimit të ulët që kanë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe pamundësia për t'i angazhuar në komisione pa pagesë, kur dihet fakti se për me marrë pjesë në një komision, pos kohës që shpenzon një anëtar i KK, duhet bartur vet çdo shpenzim tjetër për me ardhur me marrë pjesë në mbledhje të komisionit, kur dihet fakti se pjesa dërmuese e anëtarëve të KK janë nga tereni dhe kanë të vetmin burim kompensimin për anëtar të KK.

5. Në qoftë se anëtarët e Kuvendit të Komunës llogariten zyrtar publik apo autoritet publik, atëherë të njëjtin status e kanë edhe Deputetët e Kuvendit të Kosovës, vetëm se ne jemi nivel lokal, ndërkaq nuk e di nëse Ligji Nr. 03/L-048 -për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe Ligjet për Ndryshim Plotësimet e këtij ligji, a vlen vetëm për nivelin lokal apo për të gjithë zyrtarët publik të Republikës së Kosovës, në çështjen e nenit 81 ku është potencuar citati i ligjit si në shkresën e Departamentit Ligjor të MF.

Në sugjerimet e Zv. Drejtoreshës së Zyrës ligjore të MF, znj. Bahrije Berisha të potencuar në shkresë për gjetjen e formave të tjera për pagesën e komisioneve sipas Rregullores Nr. 33/2017 për paga shtesë dhe kompensime të tjera për shërbyesit civil.

Ne vlerësojmë së;

1. Përderisa anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk kanë orar të rregullt të punës, nuk mundemi me gjetur ndonjë formë tjetër të pagesës për angazhimin e tyre nëpër komisione.


2. Dispozitat Rregullores Nr. 33/2017 -për paga shtesë dhe kompensime të tjera për shërbyesit civil, rregullojnë kompensimet shtesë për shërbyesit civil jashtë orarit të punës e jo për anëtarët e KK që punojnë punë shtesë nëpër komisione.

Andaj duke ditur gjendjen e kompensimeve të stafit politik në komuna- të anëtarëve të KK, me qëllim të funksionimit sa më të mirë të Kuvendit të Komunës, kur dihet fakti se edhe neni 12.2 (d) i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale parasheh që "Kuvendi i Komunës ka të drejtë të merr çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin efikas të komunës" e kemi marrë këtë Vendim. Nisur nga kjo që potencuam më lartë, ne kërkojmë që t'lejohej kompensimi i komisioneve të formuara nga KK, për anëtarët nga Kuvendit të Komunës të përfaqësuar në komisione, apo të bëhet ndonjë zgjidhje tjetër, në të kundërtën do të kemi problem me funksionimin e Kuvendit të Komunës pasi që KK nuk mund të funksionoj pa trupa punuese- komitete e komisione.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government



Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës Kaçanikut
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 01 Nr. 060/01-18351/20 për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihiet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers

Për:	Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme, MPL
Kopje:	Kryetari i komunës së Kaçanikut Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Ilvmete Bajrami, Ministre e Ministrisë së Financave Enis Spahiu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Ngr:	Bahrije Berisha, Zv. Drejtoresh i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj, Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Referencë 014
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01. Nr. 060/01-18351/20 për kompensimin e komisioneve të kuvendit të komunës, datë 12.08.2020

I nderuar Ministër z. Rakić

E nderuara Sekretare e Përgjithshme, znj. Ukimeraj

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 0311-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01. Nr. 060/01-18351/20 për kompensimin e komisioneve të kuvendit të komunës,

I miratuar me datë: 12.08.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë : 14.08.2020.

I dërguar për shqyrtim në MF me datë: 18.08.2020.

Në shqyrtimin e përmbajtjesor të aktit, Ministria e Financave vlerëson se të gjitha kompensimet shtesë të kenë parasysh nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, neni 80, citon:

"Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim".

Po ashtu, neni 81 Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, citon:

"Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, do të kenë përparësi..."

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartë cekura, kompensimi shtesë për punonjësit, shërbyesit civil dhe zyrtarët publik të angazhuar në komisione apo në trupa të ndryshme, është i ndaluar me nenin 80 të LMFP-së. Pra, ky kufizim vlen vetëm për kategorinë që caktohet në nenin 80 të LMFP-së dhe vendimi në këtë kontekst nuk është i ligjshëm. Në anën tjetër, kompensimi i anëtarëve të jashtëm nuk ka kufizime të tilla dhe duhet të bëhet nga kategoria e dhur ekonomike e shpenzimeve.

Ministria e Financave sugjeron Komunën e Kaçanikut që të shqyrtojë forma të tjera të punës së këtyre komisioneve, që mund të kompensohen sipas Rregullores Nr. 33/2012 për shtesa në pagë dhe kompensime tjera të nëpunësve civil.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Kosova Republika
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 060/01-26898/20

Kaçanik, 30.10.2020

Në bazë të nenit 4.1 dhe 4.2 , 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike(Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-047- Për Vetëqeverisje Lokale) Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Tetor 2020 mori këtë:

V E N D I M

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A. - Njësia në Kaçanik

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i KK 01 Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 - Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A. - Njësia në Kaçanik.

2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhen të pika 2, paragrafi 2..1. të përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, si vijon:

2.1. Nga Komisioni hiqet ish anëtarja KK, Afërdita Horuni (Shehi) – anëtare e komisionit nga KK nga AAK, pasi që e njëjta ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të KK dhe rrjedhimisht i kanë pushuar edhe pozitat tjera që i ka pasur, përfshirë edhe këtë pozitë.

2.2. Për anëtare të Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A.- Njësia në Kaçanik, caktohet, **ARLINDA RAKOCI-RAKA**, anëtare e KK nga LDK.

3. Pikët tjera të Vendimit 01Nr. 60/01-368/10 të datës 29.11.2019 mbesin të pandryshuara.

4. Detyra dhe përgjegjësitë e komisionit vlerësues janë të përcaktuara me Ligjin Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike, ashtu që nga kjo datë anëtarja e emëruar e komisionit ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi të barabarta më anëtarët tjerë të komisionit vlerësues.

5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-5064/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 4.1 dhe 4.2 , 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike, e Ligjit si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-047 Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M

**Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A-
Njësia në Kaçanik**

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastërtia" SH.A për Njësinë në Kaçanik.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastërtia" SH.A , përkatësisht për njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë 3 anëtarë : 1 (Një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 (Dy)anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës., me këtë përbërje:

- | | |
|----------------------|---|
| 2.1. Afërdita Horuni | anëtar i KK nga subjekti politik i AAK, |
| 3.2. Adnan Reka | anëtar i KK nga subjekti politik i LVV, dhe |
| 3.3. Ukshin Qallaku | anëtar nga Ekzekutivi i Komunës. . |

3 Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimet e këtyre ligjeve dy ligjeve.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

Me këtë Vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe përmes kësaj drejtorie njoftohet Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastërtia" SH.A-Ferizaj, dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine/Ministry of Economy and Environment

Stamp: 04/3 2083 17.11.20
Stamp: 17.11.2020
Stamp: 020-850/19

DATA	16.11.2020
PËR/ZATO:	Venera Çerkini.Udhëheqëse e Departamentit ligjor dhe monitorim të Komunave/MPL
CC:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme/MPL Fatos Qerimi.Sekretar i Përgjithshëm/MEA
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Besnik Krasniqi, Drejtor i NJPMNP-së
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani.analiste.NJPMNP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Kaçanikut

E nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Ne.07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrëve .NJPMNP/MEA ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Nr.060/01-26898/20 i datës 30 tetor 2020 , i pranuar në MEA me datë 09.11.2020 nr. prot.2015, për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01.N.060/01-504/18 për themelimin/emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Pastërtia "sh.a-njësia në Kaçanik, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Ligji nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike ,neni 23 në listën e ndërmarrjeve publike rendit Ndërmarrjen Publike KRM Pastërtia sh.a Ferizaj në Ndërmarrje publike lokale që ofron shërbime në tri Komuna dhe Komuna e Kaçanikut ka aksione në këtë kompani 13.7% .

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon " Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Legjislacionin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare në fuqi.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës nuk është në kundërshtim me aktet në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!